



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 142, Datë 24.09.2019

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “AYEN AS ENERJJI” SH.A., NË VEPRIMTARINË
E FURNIZIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d”; nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 15 dhe 37 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.09.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 89/9 prot, datë 12.09.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqytjes mbi kërkesën e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 129, datë 29.08.2019, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERJJI” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, pas shqyrtimit të relacionit me nr. 89/9 prot, datë 12.09.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqytjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a. depozituar në ERE me shkresën nr. 515 Prot, datë 22.08.2019 për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “Ayen AS Energji ” sh.a., zotëron licencën për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me nr.245, seria Fk14, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.83, datë 16.09.2014, për një periudhë 5 vjeçare, periudhë e cila përfundon në datën 16.09.2019
- Shoqëria “AYEN AS ENERJJI sh.a. në aplikimin e saj ka adresuar edhe kërkesën për trajtimin me procedurë të përsheptuar të aplikimit për licencim në aktivitetin e kërkuar.

- Pas kësaj vendimarrje, ERE me shkresën nr. 32/37 Prot, datë 30.08.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 515/2 Prot, datë 02.09.2019, ERE dërgoi pranë shoqërisë njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim të dokumentacionit të munguar në aplikim brenda datës 06.09.2019, si dhe prova dokumnetare dhe argumentim të kërkesës për trajtimin e këtij aplikimi me procedurë të përshpejtuar.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 515/3 Prot, datë 03.09.2019, dhe nr. 515/4, datë 04.09.2019, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar si dhe argumentimet mbështetëse të kërkesës së mësipërme.
- Lidhur me kërkesën e depozituar në ERE nga shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., për të vepruar me procedurë të përshpejtuar, për licencimin në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, u krye vlerësimi i provave dhe sqarimeve përkatëse dhe u gjykua se argumentat e dhëna nga kjo shoqëri nuk justifikojnë kërkesën për licencimin me procedurë të përshpejtuar, duke qënë se shoqëria kishte dijeninë në lidhje me detyrimin për të aplikuar për rinovimin e licencës në afatet e parashikuara në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*. Spjegimet e aplikuesit në lidhje me efektet dhe impaktin që ka për shoqërinë pushimi i së drejtës së ushtrimit të aktivitetit të furnizimit për aplikuesin, në kushtet e përfundimit të afatit të licencës së tregtimit r. 241, seria T14, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, Nr. 79, datë 09.09.2014, nuk përbëjnë provë të mjaftueshme për të çuar bordin e ERE në një vendimarrje me procedurë të përshpejtuar
- Në përgjigje të kërkesës së ERE-s, shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 515/3 Prot, datë 03.09.2019 dhe shkresën nr. 515/4, datë 04.09.2019 ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.
- Aplikimi i shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:
 - **Formati dhe dokumentacioni për aplikim** (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor** (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal** (neni 9, pika 3), është plotësuar pjesërisht. Shoqëria me shkresën nr. 515/3, datë 03.09.2019 ka depozituar në ERE Vërtetimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me nr. 2186 Prot., datë 29.08.2019, nga i cili rezulton se për periudhën deri në datën e lëshimit të këtij

vërtetimi nuk ka detyrim tatimor për Tatimin mbi fitimin, Tatimin e mbajtur në Burim, Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të ardhurave të punësimit, por shoqëria ka detyrim në TVSH në vlerën 88,773 LEKË për të cilat është në procedurë apelimi për detyrimin e TVSH-së ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

- **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjise elektrike** (neni 9, pika 4.7) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- **Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar** (neni 9, pika 4.7.1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rrëzojë kërkesën për trajtimin me procedurë të përshpejtuar të aplikimit nr. 094 Prot, datë 22.08.2019, të protokolluar në ERE me nr. 515/1 Prot, datë 22.08.2019, të shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., për licencimin në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Të licencojë shoqërinë “Ayen AS Energji” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar, me kusht që të depozitojë në ERE vërtetimin për përfundimin e procedurës së apelimit për detyrimin e TVSH-së, ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti